



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 499, datë 13.09.2024**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË NUMRIN E POZICIONEVE TË PUNËS NË GJYKATËN  
E LARTË DHE GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË ME JURIDIKSION TË  
PËRGJITHSHËM BERAT, FIER DHE TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 61, 90, 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, kërkesës nr. 3991 prot., datë 30.07.2024 protokolluar me tonën nr. 3978 prot., datë 30.07.2024 të Gjykatës së Lartë, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Fier dhe Tiranë, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të njoftimit të gjykatave respektive, referuar këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA NR. 1:**

Nr.	Gjykata	Administrata Gjyqësore		Sekretare gjyqësore		Specialist IT	
		Str. Organizative ISHTE	Str. Organizative BEHET	Str. Organizative ISHTE	Str. Organizative BEHET	Str. Organizative ISHTE	Str. Organizative BEHET
1.	Gjykata e Lartë	145	148	22	25		
2.	Gj.J.P.Berat	34	33	10	9		
3.	Gj.J.P.Fier	71	70			2	1
4.	Gj.J.P.Tiranë	272	271	112	111		